

## **Deklaratë**

Duke qenë tejet mirënjohëse për bursën e ofruar nga MASHT-i, jam e lumtur të ndaj me ju këtë eksperiencë të jashtëzakonshme në universitetin KU Leuven në Belgjikë.

Dy vite më parë, kam qenë fituese e bursës së plotë ‘Master Mind Scholarship’ që ofrohet nga shteti i Belgjikës për vetëm 15 studentë në mesin e aplikantëve nga e gjithë bota. Kjo bursë, së bashku me bursën nga MASHT-i, më kanë mundësuar mbështetjen e nevojshme financiare pa të cilën ky rrugëtim nuk do të mund të realizohej.

Pas dy vite studimi, më 02.07.2022 kam diplomuar me nderime të larta (with great distinction) si Master Shkence në Arkitekturë në universitetin më të vjetër dhe më prestigjioz të Belgjikës, KU Leuven. Si rezultat i përkushtimit të vazhdueshëm gjatë këtyre viteve, u përzgjedha Laureate e gjeneratës 2020-2022 si studentja me suksesin më të lartë në këtë fakultet. Kjo arritje, pavarësisht punës dhe përkushtimit individual, mendoj se ka qenë simbol i cilësisë së lartë arsimore që e ofron Universiteti i Prishtinës. Bazuar në eksperiencën time dhe të shumë studentëve tjerë që kanë studiuar jashtë vendit, profesorët janë gjithmonë të fasionuar me përgaditjen e lartë të studentëve nga Kosova. Prandaj, duke njohur mirë potencialin e lartë të studentëve tanë, shpresoj që MASHT-i të vazhdojë këtë përkrahje financiare për sa më shumë studentë të cilët padyshim do të vazhdojnë promovimin e Kosovës jashtë vendit.

Gjatë këtyre dy viteve kam pasur eksperiencë dhe arritje të ndryshme. Në vitin e parë, punimi im është përzgjedhur në mesin e 10 punimeve më të mira nga të gjitha vitet e studimeve, dhe si rezultat, është publikuar në librin LucAs Architecturebook 2021. Pas vitit të parë, isha pjesë e shkollës verore në Gjermani të organizuar nga KU Leuven, dhe punimi im do të ekspozohet në Francë në muajin Shtator të këtij viti. Më tutje, hulumtimi im rreth Michel Foucault u vlerësua lart nga profesorët e universitetit të cilët kanë shprehur interesim të lartë për të vazhduar bashkëpunimin më tutje. Me këtë rast, kisha nderin që këtë punim ta prezantoj në Konferencën Ndërkombëtare të Filozofisë të organizuar nga Shoqata e Filozofëve të Kosovës dhe Departamenti i Filozofisë i Universitetit të Prishtinës në vitin 2021.

Në vitin e dytë, vendosa që për temë të diplomës ta trajtoj qështjen e Burgut të Gjilanit, punim i cili u notua me notën më të lartë nga mentori dhe juria e jashtme. ‘To Meet Galileo on Day Fourteen. An Eclectic Architectural Documentary: The Case of Gjilan County Prison’ ka shpalosur historitë e errëta të një ndër burgjeve më famëkeqe të ish-Jugosllavisë, ku janë torturuar shumë aktivistë politik shqiptarë në vitet e 80-ta, e në mesin e të cilëve edhe babai im. Me Burgun e Gjilanit si rast studimi, ky punim eksploron metoda të reja të punës në

arkitekturë duke e larguar këtë profesion nga karakteri destruktiv që ka në lidhje me shfrytëzimin e pakontrolluar të mjedisit dhe nevojës së pashmangshme për intervenime fizike. Në këtë formë, ky punim e paraqet arkitekturën si praktikë të mbrojtjes së mjedisit të ndërtuar e jo si agjent të shterimit të tij. Kujtimet e ish të burgosurve, metodat e komunikimit brenda burgut, poezitë dhe letrat e shkruara, torturat, gjurmët e mbetura në mure dhe shumë detaje të tjera janë shpalosur përmes vizatimeve, shkrimeve dhe maketave të përmbledhura në librin tim përfundimtar. Ky punim i është dedikuar të gjithë ish të burgosurëve politik dhe ushtarëve të luftës së Kosovës, të gjallë apo të rënë, pa të cilët ne sot nuk do të ishim këtu. Pas shpalljes si Laureate e gjenerates, fakulteti ka shprehur gadishmëri të plotë për të më përkrahur më tutje në vazhdimësi të këtij projekti, si në Kosovë ashtu edhe jashtë vendit. Prandaj, duke pasur përkrahjen edhe të institucioneve nga Kosova, mendoj se ky projekt mund të jetë vetëm fillimi i trajtimit më të gjerë të këtyre objekteve dhe ngjarjeve të padokumentuara që janë pasuri historike të Kosovës.

Duke qenë tejet falenderuese për këtë mundësi që më është ofruar, jam e lumtur t'i sjell këto suksese në Kosovë duke vërtetuar se çdo mbështetje ka vlerë të madhe dhe se investimi në studentë është gjithmonë i duhur. Gjatë dy viteve të fundit, kam qenë ambasadore në fakultetin e arkitekturës me ç'rast kam ndihmuar shumë studentë që kanë shprehur interesim për studime në këtë universitet. Tani, edhe pas diplomimit, jam plotësisht e gatshme të ndihmoj studentët tjerë nga Kosova që duan të studiojnë në KU Leuven.

Si përfundim, shpresoj që çdo student shqiptar kudo në botë të sjellë kontributin përsëri në atdhe, dhe së bashku të punojmë drejt zhvillimit të Kosovës në çdo fushë.

Gjiltinë Isufi